



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.553/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Gasper Merturi, me vendbanim në Zvicër, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet i palejuar apeli** A.nr.553/2021, i datës 02.03.2021, i parashtruar nga Gasper Merturi, me vendbanim në Zvicër, për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

## A r s y e t i m

Me datë 02.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Gasper Merturi të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 04 shkurt 2021, me të cilin thekson se ka dërguar aplikimin e tij brenda afatit me datë 19.01.2021, në ora 14:07, emri i tij nuk është gjendur në listën e votuesve jashtë Kosove, dhe se i njëjti nuk ka pranuar asnjë thirrje nga ana e KQZ-së. Kërkon nga PZAP që të pranohet ankesa si e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Gasper Merturi e dorëzuar nëpërmjet postës me datën 04 shkurt 2021, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar nga Gasper Merturi të paraqitur me datën 03.02.2021 kundër KQZ-së e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 312/2021 të datës 05.02.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se apeli i parashtruar nga Gasper Merturi është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 312/2021 të datës 05.02.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 553/2021 më datën 03.03.2021



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.